

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

6 dhjetor 2011
Ap – Kz 221/2011

NE EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si Kryetar i kolegjit, gjyqtarët e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe Salih Toplica, gjyqtarët e EULEX-it Francesco Florit dhe Charles L. Smith III si anëtarë të kolegjit, me asistimin e Zyrtares Ligjore Chiara Rojek si procesmbajtëse,


Në lëndën kundër të pandehurit Valon Miftari, i biri i Osman dhe Shkurte Sadrijaj, i lindur më 27 mars 1980 në fshatin Duzhnje, komuna e Gjakovës, i shkolluar, i pamartuar, ish polic i Kosovës me numër të kartelës 4338, me gjendje të mesme ekonomike, i mbajtur në paraburgim nga 8 deri më 24 nëntor 2003 dhe momentalisht në arrest shtëpiak në shtëpinë e tij në fshatin Duzhnje, komuna e Gjakovës,

I akuzuar sikurse në aktakuzën e ndryshuar PP nr. 598/03 e ngritur më 24 maj 2010 me Vrasje të Rëndë në kundërshtim të Nenit 147 paragrafi 11, të lexuar në lidhje me nenin 8 paragrafi 3 të KPK,

I liruar në shkallën e parë sipas rigjykimit me aktgjykimin P nr. 03/10 të Gjykatës së Qarkut të Pejës të datës 27 maj 2010 për veprën penale Vrasje në kundërshtim të Nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) për vrasjen e Sadik Zeneli (pika 1) dhe i dënuar për veprën penale Vrasje në kundërshtim të Nenit 30 paragrafi 1 të LPK të lexuar në lidhje me Nenin 9 paragrafi 3 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ) për vrasjen e Sefedin Zeneli (pika 2), dhe i dënuar me tetë (8) vjet burgim në pajtim me Nenin 30 paragrafi 1 i LPK të lexuar me Nenet 9 paragrafi 3 dhe 43 paragrafi 1 pika 1 të KP RSFJ,

Duke vepruar sipas ankesës të ushtruar nga avokati mbrojtës Fazli Balaj në emër të të pandehurit Valon Miftari më 27 prill 2011 dhe ankesës të ushtruar nga avokati Sokol Dobruna përfaqësues i palëve së dëmtuar Xhafer dhe Myrteza Zeneli më 4 maj 2011 kundër aktgjykimit P nr. 03/10 të Gjykatës së Qarkut të Pejës të datës 27 maj 2010, dhe duke pasur parasysh përgjigjen në ankesë të përfaqësuesit të palës së dëmtuar të ushtruar më 16 maj 2011, si edhe mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) në ankesat e ushtruara më 5 gusht 2011,

Pas mbajtjes së seancës të hapur më 6 dhjetor 2011 në praninë e prokurores Gabriele Walentich përfaqësuese e ZPShK, të pandehurit Valon Miftari, avokatit të tij mbrojtës Fazli Balaj, palës së dëmtuar Xhafer Zeneli dhe përfaqësuesit të tij, avokatit Sokol Dobruna, pas këshillimit dhe votimit në të njëjtën ditë, në pajtueshmëri me Nenet 420, 424 dhe 426 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë



AKTGJYKIM

Ankesa e avokatit mbrojtës Fazli Balaj në interes të të pandehurit Valon Miftari e datës 27 prill 2011 kundër aktgjykimit P nr. 03/10 të Gjykatës së Qarkut të Pejës të datës 27 maj 2010 PRANOHET.

Aktgjykimi P nr. 03/10 i Gjykatës së Qarkut të Pejës i datës 27 maj 2010 ndryshohet me sa vijon:

I pandehuri Valon Miftari, me të dhëna personale më lart LIROHET për veprën penale Vrasje në kundërshtim të Nenit 30 paragrafi 1 të LPK/ Neni 147 paragrafi 11 të KPK të lexuar në lidhje me Nenin 9 paragrafi 3 të KP RSFJ / Neni 8 të KPK për vrasjen e Sefedin Zeneli (pika 2).

Dënimi prej tetë (8) vjet burgim i shqiptuar kundër Valon Miftari me aktgjykimin P nr. 03/10 të Gjykatës së Qarkut të Pejës të datës 27 maj 2010 anulohet.

Ankesa e paraqitur nga avokati Sokol Dobruna Përfaqësues i palëve të dëmtuara Xhafer dhe Myrteza Zeneli më 4 maj 2011 kundër aktgjykimit P nr. 03/10 të Gjykatës së Qarkut të Pejës të datës 27 maj 2010 REFUZOHET.

Shpenzimet e procedurës penale në shkallën e dytë do të paguhen nga fondet buxhetore në pajtueshmëri me Nenet 99, 100 dhe 103 të KPPK.


ARSYETIMI

I. Historia e procedurës

Më 8 nëntor 2003, në mbrëmje në fshatin Duzhnje, komuna e Gjakovës, Sadik Zeneli dhe Sefedin Zeneli janë qëlluar për vdekje.

Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ngriti aktakuzën P nr. 598/2003 më 22 tetor 2004, duke e akuzuar të pandehurin me Vrasje të atëçastshme (vrasje e provokuar) në kundërshtim të Nenit 33 të LPK ose në mënyrë alternative me vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor në kundërshtim të Nenit 148 të Kodit të Procedurës së Përkohshme Penale të Kosovës (KPPPK) për vrasjen e Sadik dhe Sefedin Zeneli. Më 22 nëntor 2004 aktakuza është konfirmuar në tërësi nga Gjykata e Qarkut të Pejës.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur në prill, maj dhe qershor 2006. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori paraqiti një aktakuzë të ndryshuar duke akuzuar të pandehurin me disa vrasje në kundërshtim të Nenit 30 paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPK i barasvlershëm me Nenin 147 paragrafi 11 të KPPK. Më 12 qershor 2006, Gjykata e Qarkut të Pejës me aktgjykimin P nr. 398/04, ka shpallur të pandehurin fajtor për kryerjen e dy vrasjeve në kundërshtim me Nenin 30 paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPK të dënuar me trembëdhjetë (13) vjet për secilën vrasje. Një dënim unik prej pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim është shqiptuar në pajtueshmëri me Nenin 48 paragrafi 2 pika iii të KP RSFJ.



Më 5 gusht 2008, duke vepruar sipas ankesave të ushtruara nga avokatët mbrojtës në nëntor 2006, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin AP nr. 583/06, pjesërisht miratoi dhe refuzoi pjesët e mbetura. Kështu i pandehuri është shpallur fajtor për dy vrasje në kundërshtim të Nenit 30 paragrafët 1, 2 dhe 3 të LPK dhe Gjykata Supreme shqiptoi një dënim të vetëm prej pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim kundër Valon Miftari.

Më 13 nëntor 2008, i pandehuri paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit P nr. 398/2004 të Gjykatës së Qarkut të Pejës të datës 12 qershor 2006 dhe aktgjykimit AP nr. 583/06 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 5 gusht 2008. Më 11 dhjetor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi aktgjykimin Pkl-Kzz nr. 23/09. Gjykata Supreme pranoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe anuloi të dy aktgjykimet e kundërshtuara. Lënda u kthye mbrapa për rigjykim.

Gjatë zhvillimit të rigjykimit në maj 2010, prokurori ndryshoi aktakuzën për Vrasje e Rëndë që tejkalon kufijtë e mbrojtjes së Nevojshme në kundërshtim të Nenit 147 paragrafi 11 të lexuar në lidhje me Nenin 8 paragrafi 3 të KPK. Më 27 maj 2010 trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut të Pejës me aktgjykimin P nr. 3/2010, liroi të pandehurin për veprën penale Vrasje në kundërshtim të Nenit 30 paragrafët 1 dhe 3 të LPK për vrasjen e Sadik Zeneli, pasi që mbrojtja e nevojshme përjashton përgjegjësin e tij penale në pajtueshmëri me Nenin 390 paragrafi 1 pika 2 të KPPK. Gjykata e shkallës së parë megjithatë shpalli Valon Miftari fajtor për Vrasje në kundërshtim të Nenit 30 paragrafi 1 të LPK në lidhje me Nenin 9 paragrafi 3 të LPK pasi që i pandehuri ka vepruar në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme. I akuzuari është dënuar me tetë (8) vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 30 paragrafi 1 të LPK në lidhje me Nenin 9 paragrafi 3 dhe Neni 43 paragrafi 1 pika 1 të KP të RSFJ. Të njëjtën ditë, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut të Pejës po ashtu lëshoi një aktvendim P nr. 3/2010 duke shqiptuar arrest shtëpiak kundër të pandehurit derisa aktgjykimi të marr formën e prerë në pajtueshmëri me Nenin 278 paragrafi 1, Neni 281 paragrafi 1 dhe Neni 393 paragrafi 1 të KPPK. Dokumentet e udhëtimit të Valon Miftari janë konfiskuar në pajtueshmëri me Nenin 278 paragrafi 9 të KPPK.


II. Parashtrirat e palëve

A. Ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës Fazli Balaj në emër të të pandehurit Valon Miftari dhe Përgjigja në ankesë e përfaqësuesit të palës së dëmtuar

Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër aktgjykimit P nr. 3/10 të Gjykatës së Qarkut të Pejës mbi arsyet e mëposhtme. Ai i propozoi Gjykatës Supreme të Kosovës të anuloi aktgjykimin e kundërshtua dhe kthej lëndën për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose në mënyrë alternative ‘të hedhë poshtë akuzat kundër të akuzuarit’.

A.1. Shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale nën Nenin 403 paragrafi 1 pika 12 të KPPK

Në këndvështrimin e mbrojtjes, aktgjykimi i kundërshtuar është i paqartë dhe bishtnues, pasi që përshkrimi faktik brenda dispozitivit është i mjegullt. Përveç kësaj, nuk janë



përmendur arsyet pse i Pandehuri ka tejkualuar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Gjykata e shkallës së parë ndau ngjarjen penale në dy pjesë ndonëse të dy vrasjet kishin ndodhur në vendin dhe në kohën e njëjtë, nën rrethana të njëjta. Po ashtu ekziston edhe një mospërputhje në mes të arsyeve të aktgjykimit dhe përmbajtjes së provave të paraqitura.

Mbrojtja po ashtu pohon se aktgjykimi i kundërshtuar është i paligjshëm pasi që Gjykata e Qarkut nuk ka vepruar në përputhje me udhëzimet e Gjykatës Supreme të Kosovës në aktgjykimin e saj Pkl-Kzz nr. 23/2009. Instanca më e lartë sugjeroi të lexohet me kujdes dëshmia e Dëshmitarit Blerim Balijaj. Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë rikonstruktimin e vendit të ngjarjes dhe arsyet për mos bërjen e kësaj janë të pabazuara. Avokati mbrojtës në fund pretendon se ka mospërputhje në mes të kushteve të ndriçimit në vendin e ngjarjes dhe gjetjeve të Gjykatës së Qarkut.

A.2. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nën Nenin 405 të KPPK-së

Avokati mbrojtës pohon një vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike pasi që Gjykata e Qarkut nxori përfundimin se vrasja e dytë kundër Sefedin Zenelit ishte kryer në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme. Prapë, gjykata e shkallës së parë nuk veproi sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme dhe kryesisht e bazoi aktgjykimin e vet në dëshminë e Blerim Balijajt. Ai kundërshton disa gjetje të Gjykatës së Qarkut sa i përket këtyre fakteve: viktimat ishin më të fuqishme se Valon Miftari; Blerim Balijaj pretendohet se është dëshmitar-okular i ngjarjes në muzg, nga ulësja e prapme e veturës e cila shpejtonte me 100 km. Mbrojtja dyshon në besueshmërinë e Blerim Balijajt dhe propozon të thirret një ekspert i trafikut me qëllim të vlerësimit të saktësisë së dëshmive të tij.

A.3. Shkelja e ligjit penal nën Nenin 404 të KPPK-së


Mbrojtja pohon se rrethanat përkitazi me mbrojtjen e nevojshme në këtë rast ekzistojnë. Ai i vendos në krye këto elemente:

- Valon Miftari, si polic aktiv në Luftën kundër krimit të organizuar, deklaroi se atë e kishte përcjellë, vëzhguar dhe kërcënuar Sadik Zeneli dhe persona të tjerë sepse policia ishte duke e hetuar vrasjen e Hajdar Ahmetit dhe i Pandehuri siguroi informacione mbi Sadik Zenelin. Valon Miftari ishte nën mbrojtje. Më herët, dy policë të cilët punonin në rastet e krimit të organizuar ishin vrarë në rajonin e Gjakovës.

- Sulmi kundër Valon Miftarit ishte organizuar nga viktimat dhe nuk kishte marrë fund. Ai tentoi të mbrojtë veten duke i përdorur duart e tij, siç është treguar me lëndimet në pjesët e trupi të tij. Ai i paralajmëroi të dy viktimat se ishte polic dhe se kishte armë. Ai përdori armën e tij në fazën e fundit kur jeta e tij ishte rrezikuar, gjersa Sefedin Zeneli ishte duke e grushtuar atë nga prapa.

Sipas pikëpamjes së mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë nuk iu ka bindur gjetjeve të Gjykatës Supreme sepse është dashur të zbatohet ligji më i favorshëm për të Akuzuarin nga Neni 8 i KPK-së.

A.4. Vendimi mbi dënimin nën Nenin 406 të KPPK-së



Avokati mbrojtës pohon se duke marrë parasysh se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, rrjedhimisht janë thyer edhe dispozitat ligjore mbi dënimin. Kjo qoi drejt një dënimi krejtësisht të padrejtë.

A.5. Pranueshmëria e Ankesës nga Përfaqësuesi i Palës së Dëmtuar

Avokati mbrojtës parashtron se Ankesa e Përfaqësuesit të palëve të dëmtuara duhet të hedhet poshtë si e papranueshme pasi që kjo nuk bie nën sferën e Nenit 399 paragrafit 3 të KPPK-së. Sa i përket vrasjes së Sadik Zenelit, ankesa “lidhur me vendimin e gjykatës mbi sanksionet penale për veprat penale të kryera kundër jetës ose trupit” nuk është e pranueshme pasi që Valon Miftari ishte shfajësuar. Sa i përket vrasjes së Sefedin Zenelit, Ankesa trajton vetëm vërtetimin e gjendjes faktike dhe cilësimin juridik të veprës penale, arsye të cilat nuk lejohen nën këtë dispozitë.

B. Ankesa e ushtruar nga Avokati Sokol Dobruna, Përfaqësues i Palëve të Dëmtuara

Përfaqësuesi i Palëve të Dëmtuara ushtroi Ankesë mbi arsyet e përjashtimit të përgjegjësisë lidhur me vrasjen e Sadik Zenelit dhe vendimit mbi dënimin lidhur me vrasjen e Sefedin Zenelit. Ai pohon se cilësimi juridik sa i përket vrasjes së Sadik Zenelit duhet të ndryshohet për Vrasje me paramendim nën Nenin 30 të LPK-së, duke u bazuar në faktet në vijim të mbështetura nga provat:

- Sadik Zeneli ishte në konflikt me babanë e Valon Miftarit, dhe prandaj motivi i vrasjes mund të ketë qenë hakmarrja. Për më tepër, Sadik Zeneli ka kontribuar në punësimin e Valon Miftarit si polic.

- Sefedin Zeneli donte të shihte se çfarë po bënin jashtë Sadik Zeneli dhe Valon Miftari. Të dy viktimat ishin duarthatë, edhe pse Valon Miftari ishte kinse i rrezikuar nga ata. Sadik Zeneli sapo deshi të largohej kur Valon Miftari e ndaloi atë. Valon Miftari doli jashtë i gatshëm, i veshur me rroba sportive duke mbajtur një armë të mbushur me 30 fishekë.

- Një dëshmitar pa katër persona duke dalë shitores të cilët më pastaj filluan të rriheshin. Gjykata e shkallës së parë nuk arriti ta kërkojë këtë person të katërt.

- I akuzuari ishte i trajnuar në karate dhe i përdori këto shkathtësi për tu liruar nga kacafytja për ta marrë armën prapa dhe për ta vrrarë Sadik Zenelin.

Sa i përket vrasjes së Sefedin Zenelit, Përfaqësuesi i Palëve të Dëmtuara parashtron si në vijim: Një dëshmitar dëshmoi se Sefedin Zeneli ishte duke bërë titur kur Sadik Zeneli u vra dhe ai lëvizi në drejtim të Valon Miftarit i cili e qëlloi atë menjëherë; Sefedin Zeneli në atë kohë ishte duarthatë. Gjykata e shkallës së parë arriti gabimisht në përfundim lidhur me ekzistimin e rrethanave që arsyetojnë mbrojtjen e nevojshme, edhe pse Valon Miftari paraprakisht e vrau Sadik Zenelin. Përveç kësaj Gjykata e Qarkut nuk arriti ta vlerësojë drejt gjendjen psikologjike të Sefedin Zenelit (të vrrarë në një largësi prej 16 cm).

Në fund, sipas këndvështrimit të Përfaqësuesit, gjykata e shkallës së parë mbështeti aktgjykimin e vet në prova të dobëta dhe është dashur ta dënonte të Pandehurin për Keqpërdorim të autorizimeve në polici. Ai kundërshton vlerësimin e gjendjes mendore të Valon Miftarit të bërë nga gjykata e shkallës së parë.



C. Përgjigja e ZPShK-së

ZPShK i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta anuloj aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthej lëndën për rigjykim trupin e njëjtë gjykues apo ndonjë trup gjykues tjetër. Prokuroria parashtron se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo to plotë të gjendjes faktike si dhe shkelje të ligjit penal.

C.1. Shkelja substanciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenin 403 të KPPK-së dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së

Gjykata e shkallës së parë është kërkuar që ta ekzaminojë Dëshmitarin Blerim Balijaj me kujdes të veçantë dhe të vlerësoj me kujdes besueshmërinë e tij. Sidoqoftë, gjykata e shkallës së parë është kufizuar në përsëritjen e gjetjeve të aktgjykimeve të mëparshme duke i shpërfillur mospërputhjet potenciale në mes të dëshmisë së Balijajt dhe provave tjera. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban sqarime lidhur me çështjet në vijim


Lidhur me ndriçimin e vendit të krimit, Prokurori i Shtetit nuk pajtohet me këtë vlerësim të bërë nga gjykata e shkallës së parë, se ka qenë e mundur për Blerim Balijajn ta shoh atë për të cilën ka dëshmuar. Ndriçimi i dobët është konfirmuar edhe nga dëshmitarët tjerë. Mungesa e vlerësimit të drejtë e natyrës së përlëshjes nga trupi ri-gjykues vazhdimisht ndikon në vlerësimin e drejtë nëse Valon Miftari ka vepruar në situatë të mbrojtjes së domosdoshme. Disa dëshmitarë kanë vërtetuar shtyrjen dhe tërheqjen në mes katër personave, kurse Blerim Balijaj ka përshkruar përlëshjen si të dhunshme edhe pse ai ka pranuar gjatë shqyrtimit kryesor se nuk e ka parë sulmin e Sefedin Zenelit kundër Valon Miftarit.

Prokurori i shtetit pohon se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë ndonjë qëndrim specifik lidhur me shpejtësinë e veturës përkundër mospërputhjeve të dëshmimeve të dëshmitarëve lidhur me këtë çështje. Shpejtësia prej rreth 60 dhe 80 km/h është shtjelluar nga Blerim Balijaj, kurse dëshmitarëve të tjerë ju kujtohej se ishin duke lëvizur shumë shpejt ndoshta 110 km/h, 100 km ose 80 km.

Prokurori i shtetit vëren se prania e personit të katërt në vendin e krimit është deklaruar nga disa dëshmitarë, përkatësisht nga Haki Hasani dhe Blerim Balijaj. Sidoqoftë, gjykata e shkallës së parë vetëm ka pranuar praninë e këtij individi vetëm si *en passant* dhe nuk ka bërë përpjekje që ta gjej dhe identifikoj këtë person.

Prokuroria është e mendimit se dëshmitë e dëshmitarit Blerim Balijaj janë larg nga të qenit të qëndrueshme. Ekzistojnë mospërputhje në mes të dëshmimeve të tij të dhëna në faza të ndryshme të procedurës, dhe kundërthënie në mes të dëshmimeve të tij dhe dëshmimeve të dëshmitarëve të tjerë. Si rrjedhojë, Prokurori i shtetit parashtron se gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur obligimit të saj sipas nenit 459 paragrafit 2 të KPPK-së, për t'i shqyrtuar në hollësi dëshmitë e Blerim Balijajt.

ZPShK-ja gjithashtu vëren se Gjykata Supreme vetëm i rekomandon trupit ri-gjykues për ta bërë rikonstruktimin e ngjarjes në mënyrë që të vlerësohen dëshmitë e Blerim Balijajt. Prandaj, Prokurori i shtetit parashtron se kjo nuk përbën shkelje të nenit 459 paragrafit 2



të KPPK-së. Është vërejtur se në prill 2010, trupi gjykues ja urdhëruar inspektimit dhe rikonstruktimin e vendit, dhe më vonë e ka anuluar pasi që kushtet meteorologjike në ditën e ngjarjeve kritike nuk mund të krijoheshin. Përveç kësaj, si duket Prokurori i shtetit asnjëherë nuk e ka tërhequr kërkesën për inspektimin dhe rikonstruktimin e vendit të ngjarjes, edhe pse ky fakt përmendet në aktgjykim. ZPShK-ja është e mendimit se inspektimi dhe rikonstruktimi i vendit të ngjarjes do të ishte i rëndësishëm së madhe në qartësimin e kundërthënies të gjetura në dëshmitë e Blerim Balijajt.

C.2. Shkelja e ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së

ZPShK-ja pretendon se nuk ka asnjë pengës ligjore për ta bërë një vlerësim të ndarë për ngjarjet e ndara ose faktet përderisa gjykata ofron një sqarim të qartë lidhur me konkluzionet e arritura. Sidoqoftë, në këtë rast, gjykata e shkallës së parë ka dhënë një sqarim i cili është bërë i pavlefshëm nga vlerësimi i pasigurt i gjendjes faktike dhe nuk është në përputhje me provat e administruara gjatë gjyimit.

Lidhur me vrasjen e Sadik Zenelit, Prokurori i shtetit thekson si në vijim: a) organet vitale të trupit të Sadikut kanë qenë cak i Valon Miftarit; b) trajektorja e plumbave; c) mungesa e lëndimeve të rëndësishme në trupin e Valon Miftarit; d) prania e personit të katërt në përleshje me Sefedin Zenelin; e) sipas raportit të balistikës, arma e të akuzuarin nuk ka mundur të shtijë në mënyrë automatike; f) Valoni Miftari është përshkruar nga Blerim Balijaj si pjesëmarrës aktiv në përleshje; g) në momentin kur Sadiku është mundur ta kap armën e Valon Miftarit, ajo ka qenë e pambushur; h) gjendja mendore e Valon Miftarit në kohën e vrasjes.

Sa i përket vrasjes së Sefedin Zenelit, ZPShK-ja i referohet: a) dëshmisë së Blerim Balijajt sipas së cilës Valon Miftari menjëherë e ka shtënë në Sefedin Zenelin, pas të parit; b) ekspertiza e gjendjes mendore të të pandehurit sipas së cilës ekspertët nuk kanë qenë në gjendje të vërejnë ndonjë ndryshim në gjendjen emocionale gjatë kryerjes së veprës sepse ka ndodhur brenda një afati shumë të shkurtë kohorë; c) vlerësimi i gjendjes mendore të Valon Miftarit të bërë nga trupi gjykues është kundërthënës me vetveten.


C. 3. Çështjet tjera të ngritura nga avokati mbrojtës dhe nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar

ZPShK-ja nuk e konsideron të domosdoshëm adresimin e çështjeve në lidhje me ligjin më të favorshëm për të akuzuarin dhe dënimin joadekuat të shqiptuar ndaj të pandehurit.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

A. Kompetenca dhe procedura pranë Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës ka kompetenca që të vendosë mbi ankesat sipas neneve 26 paragrafit 1 dhe 398 të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është përbërë në pajtim me nenin 3 paragrafin 7 të Ligjit nr. 03/L-953 mbi kompetenca, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Kolegji i



Gjykatës Supreme ka mbajtur seancë publike më 6 dhjetor 2011. Palët janë njoftuar me kohë dhe kanë marrë pjesë në seancë.

B. Pranueshmëria e ankesave të paraqitura nga avokati mbrojtës Fazli Balaj dhe avokatit Sokol Dobruna përfaqësues i palës së dëmtuar


Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 27 maj 2010. Valon Miftari e ka pranuar aktgjykimin më 15 prill 2011, dhe avokati i tij mbrojtës më 14 prill 2011, siç është vërtetuar dhe pranuar me fletë-dërgesë. Aktgjykimi i kundërshtuar i është dërguar palës së dëmtuar dhe përfaqësuesit të tij më 15 prill. Ankesa e avokatit mbrojtës është paraqitur përmes postës më 20 prill dhe është pranuar nga gjykata më 27 prill. Ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar është dërguar me postë dhe është pranuar nga Gjykata e Qarkut më 4 maj 2011. Është e pamundur të vërtetohet kur është dërguar kjo ankesë pasi që vula postare është e palexueshme. Avokati mbrojtës rrjedhimisht ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës së përfaqësuesit më 16 maj 2011. Mendimi i ZPShK-së është pranuar nga Gjykata Supreme më 5 gusht 2011.

Është vërejtur se palët e dëmtuar dhe/ose përfaqësuesit e tyre nuk kanë paralajmëruar ankesë brenda tetë ditëve siç është e përcaktuar me nenin 400 paragrafin 1 të KPPK-së, gjersa avokati mbrojtës ka paralajmëruar ankesën e tij gjatë seancës së 27 majit 2011. Megjithatë, pasi që i pandehuri është dënuar me burgim, përjashtimi i përgjithshëm i nenit 400 paragrafit 4 të KPPK-së është i zbatueshëm në këtë rast dhe palët e dëmtuara janë liruar nga paralajmërimi i ankesës së tyre.

Të dyja ankesat do të konsiderohen si të parashtruara me kohë në përputhje me Nenin 398 të KPPK-së. Neni 398, par. 3 përcakton që pala e dëmtuar ka të drejtë që të ushtrojë ankesë “vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale të kryera ndaj jetës dhe trupit [...]”. Ankesa e palës së dëmtuar ka të bëjë me arsyet e lirimit nga përgjegjësia penale, kualifikimin ligjor të veprës penale dhe dënimin joadekuat. Avokati Sokol Dobruna po ashtu u pajtua gjatë seancës së gjykimit se Ankesa kishte tejkaluar fushëveprimin e Nenit 398 të KPPK-së. Gjykata Supreme gjatë shpalljes së kësaj ankesë si të pranueshme do të kufizohet në vlerësimin e arsyeve të ankesës lidhur me “sanksionet penale”.

C. Meritat e Ankesave

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pranohet ankesa e avokatit mbrojtës. Aktgjykimi i kundërshtuar mbështetet në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike në kundërshtim me Nenin 405, par. 2 të KPPK-së. Ankesa e palës së dëmtuar lidhur me sanksionet penale refuzohet si e pabazë. Aktgjykimi i kontestuar duhet të ndryshohet siç u tha më lart, ndërsa i pandehuri Valon Miftari të lirohet për vrasjen e Sefedin Zenelit në bazë të Nenit 405, par. 2 të KPPK-së. Aktgjykimi i kundërshtuar po ashtu përmban shkelje të ligjit penal sipas Nenit 404, par. 1 dhe 2 të KPPK-së, lidhur me Nenin 8, par. 1 të KPPK-së. Sa u përket shkeljeve të neneve 404 dhe 405 të KPPK-së, ato tashmë janë vërtetuar, kështu që Gjykata Supreme e Kosovës nuk e sheh të nevojshme t'i adresojë arsyet e tjera të ankesës.



Për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Qarkut ka konstatuar se i pandehuri ka vepruar në mbrojtje të domosdoshme, por ka tejkaluar kufijtë e kësaj mbrojtjeje. Duke pasur parasysh faktet e vërtetuara mbi të cilat gjykata e shkallës së parë është mbështetur gjatë nxjerrjes së aktgjykimit të saj, konstatimi i saktë i “ligjit më të favorshëm” do të kishte çuar tek shfajësimi i të pandehurit. Në kundërshtim me gjetjet e aktgjykimit të kundërshtuar, është dashur të zbatohet Neni 8, par. 2 i KPK-së dhe jo Neni 9, par. 3 i KP të RSFJ-së. Në këtë mënyrë, Gjykata e Qarkut nuk ka zbatuar mendimin juridik të Gjykatës Supreme gjatë nxjerrjes së aktgjykimit të datës 11 dhjetor 2009.

Edhe pse Neni 429, par. 3 i KPPK-së nuk përbën një urdhër të qartë për të zbatuar mendimin ligjor të gjykatës së shkallës së dytë, sipas standardeve evropiane së paku do të kishte qenë e nevojshme që ky aktgjykim të kundërshtohet në mënyrë të përshtatshme. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur edhe pse Gjykata Supreme dy herë ka konstatuar se duhet të zbatohet Neni 8 i KPK-së si dispozita më e favorshme¹. Madje as pa i diskutuar argumentet e Gjykatës së Qarkut, ishte e qartë se zbatimi i Nenit 9 të KP të RSFJ-së në vend të Nenit 8 të KPK-së ka dëmtuar të pandehurin. Nuk është kontestuese krahasimi i dispozitave me qëllim të shtjellimit të asaj se cila dispozitë është më e favorshme në kuptim të Nenit 2, par. 2 të KPK-së, por kjo gjë nuk bëhet në mënyrë abstrakte por zbatimi i tillë duhet të jetë konkret.² Por, gjykata e shkallës së parë përfundimisht ka dështuar në vërtetimin e drejtë të kësaj norme. Në të vërtetë, i ka konsideruar thjesht disa prej parakushteve për arsyetimin e “mbrojtjes së domosdoshme”, sipas Nenit 9 të KP të RSFJ-së dhe ka lënë jashtë pikën më të rëndësishme, përkatësisht atë që veprimi i mbrojtjes është “**absolutisht i domosdoshëm**”. Kjo është vetë thelbi i çështjes që shpie tek dënimi dhe jo tek lirimi i të pandehurit.


Gjykata e shkallës së parë me të drejtë arsyeton se ka pasur **sulm të kundërligjshëm** nga ana e të ndjerit Sefedin Zenelit, se ky sulm ka qenë i **menjëhershëm** dhe se i pandehuri është munduar ta shmangë. Duke vepruar kështu, vrasja e tij është dashur të arsyetohet në qoftë se nuk do të kishte qenë “**proporcionale**” në kuptim të Nenit 8 të këtij Kodi. Gjykata e shkallës së parë është pajtuar “se Valoni ka qenë më i rraskapitur sesa Sefedini, sepse vetëm pak çaste më herët ai ishte konfrontuar me dy sulmues”. Ajo gjithashtu kishte konsideruar se “pasi që Sefedini kishte parë xhaxhain e vet të vdekur, ai po ashtu do të kishte dëshiruar ta shihte edhe Valonin të vdekur, d.m.th. dëshironte të hakmerrej. Valoni ishte i hidhëruar nga sulmi, edhe ai ndjente një frikë të madhe, por kjo gjë nuk e pengoi aftësinë e tij për të kuptuar dhe të për vendosur.”³ Më vonë shtohet edhe pjesa: “madje tepër i frikësuar për jetën e vet.”

Përkundër kësaj, Gjykata e Qarkut ka konstatuar se i pandehuri ka mundur të rezistojë duke mos vrarë agresorin. Ajo ka pretenduar se pas vrasjes së Sadik Zenelit, i pandehuri kishte për t’u përballur vetëm me një agresor të cilin “do të kishte mundësi ta qëllonte në ndonjë pjesë tjetër jo vitale të trupit, duke parandaluar vdekjen e tij, apo me të cilin do të

¹ Aktgjykimi Pkl-Kzz nr. 23/09 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 11 dhjetor 2009, faqet 10 dhe 17

² Aktgjykimi P nr. 03/10 i Gjykatës së Qarkut të Pejës, i datës 27 maj 2010, faqe 23

³ Aktgjykimi P nr. 03/10 i Gjykatës së Qarkut të Pejës, i datës 27 maj 2010, faqe 24



mund të rrihej, apo do të mund të ikte” dhe ky argumentim përmbillet me fjalët: “ai (i pandehuri) do të mund të rezistonte sulmin pa e vrarë atë”.⁴

Një vlerësim i tillë nuk qëndron, sepse duke pasur parasysh vetëm argumentet e cituara më sipër gjatë përshkrimit të gjendjes me të cilën po përballej i pandehuri, provohet se reagimi i të pandehurit nuk ka qenë jo-proporcional me shkallën e agresionit. Pranohet se nuk ka qenë “**absolutisht e domosdoshme**” (kushti i pafavorshëm nga Neni 9 i KP të RSFJ-së) që të shtijë me armë, por së paku është nënkuptuar dhe ka qenë e pranueshme që të reagohej me një mjet të tillë të mbrojtjes. Gjykata e Qarkut nuk ka arsyetuar lidhur me asnjë masë tjetër alternative konkrete e cila do të mund të shfrytëzohej me qëllim të evitimit të të shtënave vdekjeprurëse. Argumentet e gjykatës së shkallës së parë janë thjesht vetëm konstatime të bëra pa vlerësuar fare situatën konkrete dhe pa përshkruar fare rrugëdaljet tjera konkrete të të pandehurit. Në aktgjykimin e kundërshtuar mungojnë sqarimet lidhur me atë se në çfarë mënyre i pandehuri ka mundur t’i evitonte pjesët vitale të kundërshtarit të tij, edhe pse “e shtëna është shkrepur nga një distancë shumë e afërt”. Nuk është e besueshme se i pandehuri është dashur të ketë mundësinë për të ikur apo për të mënjeluar agresionin me ndonjë mjet tjetër për ndërprerjen e sulmit të kundërligjshëm. Kjo gjë vlen sidomos duke pasur parasysh në aktgjykimin e kundërshtuar dëshminë e “dëshmitarit kyç” Blerim Balijajt i cili kishte deklaruar: “Sefedini iu bashkua Sadikut. Të dy burrat po goditnin Valonin. Sipas dëshmitarit Valoni **po mundohej të ikte**, por këta dy burra nuk e lejonin, të dytë duke e kapur.”⁵

I pandehuri nuk ka shtënë pa lidhje por u kishte tërhequr vërejtjen të dy sulmuesve se do të mund ta përdorte armën personale. Ai e bëri këtë duke qëlluar në agresorin e parë në prani të dytë i cili prapëseprapë iu qas të pandehurit duke e shtyrë të njëjtin për të reaguuar.

Ekzistimi i një sulmi të vërtetë serioz i cili arsyeton gjuajtjen e sulmuesve ilustron me faktin se veprimi agresiv nuk do të kishte qenë i ndarë në dy etapa, por vetëm **si një veprim**. Kjo perspektivë tregon se ka pasur rrezik të vërtetë për jetën e të pandehurit. Në aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut thuhet: “Duke pasur parasysh faktin se Sefedini ishte më i gjatë sesa Valoni dhe më i rëndë se ai, ka pak mundësi që Valoni të ketë mundur të çohet me Sadikun dhe pastaj ta qëllonte Sefedinin, i cili ishte ende sipër tij.”⁶ Arsyetimi vazhdon pastaj me këto fjali: “**Trupi gjykues ka pranuar se Valoni ka qëlluar Sefedinin në fytyrë në çastin e fundit para se Sefedini ta kapte**”. Aktgjykimi në vazhdim thotë: “Përfundimi logjik është se Sefedini ishte duke iu afruar Valonit, pasi xhaxhai kishte rënë përdhe i qëlluar, në mënyrë agresive. Valoni qëlloi njëherë Sefedinin duke e goditur me plumb në krah, por **Sefedini nuk u ndal, duke iu afruar Valonit i cili pastaj nga një distancë shumë e shkurtër e qëlloi atë në kokë**”.

Duke pasur parasysh edhe atë se i pandehuri e dinte se i tërë sulmi ishte shkaktuar nga masat hetimore të ndërmarra nga ai lidhur me vrasjen e një polici tjetër, ai kishte arsye të mira për të supozuar se situata ishte shumë serioze dhe kërcënuese për jetën e tij. Duke

⁴ Aktgjykimi P nr. 03/10 i Gjykatës së Qarkut të Pejës, i datës 27 maj 2010, faqe 24

⁵ Aktgjykimi P nr. 03/10 i Gjykatës së Qarkut të Pejës, i datës 27 maj 2010, faqe 13

⁶ Aktgjykimi P nr. 03/10 i Gjykatës së Qarkut të Pejës, i datës 27 maj 2010, faqe 22

